Olsi Isufaj
Digitally signed by Olsi Isufaj
Date: 2022.12.06 11:51:13 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER FLORA M. MHILLI
ADRESA TEODOR KEKO,
PALL."ALES"
TEL: 689012805

MARRËVESHJE SIGURUESE

Nr. repertori: 2059 **Nr. koleksioni: 1439**

Tirane më 16/11/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË FLORA M. MHILLI NOTER TIRANË

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, date 29.07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10.03/2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, date 20/12/2018 "Per Noterine", i ndryshuar

A20220503501518157 36

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE Tirane
ZYRA VENDORE Tirane
NR. 2057 REP.
NR. 11434 KOL.

Taksa e pullës E PAGUAR

MARREVESHJE SIGURUESE MBI AKSIONET E SHOQERISE

Ne Tirane, sot me date 16 / 11 / 2022 (dymije e njezet e dy), para meje noterit/es Flora Milli, anetar/e i/e Dhomes Kombetare te Noterise Tirane, me Zyre Vendore ne adresen Rr. "T. Kelio", u paraqiten personalisht palet:

BARREMARRESI: BANKA KOMBETARE TREGTARE Sha. – Dega Rruga Elbasanit, regjistruar ne Gjykaten e Tiranes me Vendimin nr.17469, dt. 23.07.1997, me numer unik identifikimi te subjektit (NIPT) J62001011Q perfaqesuar nga:

- **Z. Erion Ermal Hoxha**, i/e datëlindjes 02.09.1978 shtetas/e Shqiptar/e, mbajtës/e i/e dokumentit të identifikimit: **karte identiteti** me Nr. 034304985, në cilësinë e 035003291 të Deges së BKT-së Rruga Elbasanit.
- Zj. Elvira Barjam Proda, i/e datëlindjes 30.10.1981 shtetas/e Shqiptar/e, mbajtës/e i/e dokumentit të identifikimit: karte identiteti me Nr. 035003291, në cilësinë e Drejtuese Marketingu te Deges se BKT-së Rruga Elbasanit.

Ketu me poshte e quajtur "**Banka**", "**BKT**" ose "**Barremarresi**"

BARREDHENESI:

"UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SH.A., me zyre qendrore te shoqerise ne Shqiperi ne adresen Rruga e Kavajës, Ndërtesa 133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tirane, Shqiperi, nje shoqeri e krijuar qe vepron si person juridik ne baze te ligjeve shqiptare, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit ne date 27/09/2017, me Numer Unik te Identifikimit te Subjektit (NUIS) L72320033P, e regjistruar ne Organet Tatimore Tirane me NIPT Nr. L72320033P, e cila e ka miratuar kete kredi me Vendim te Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SH.A Nr. 573 Prot., date 7.11.2022 dhe perfaqesohet nga:
- Z. Elton Fatmir Kacidhja, i datelindjes 18.12.1982, shtetas Shqiptar, mbajtes i dokumentit te identifikimit Pasaporte me Nr. BB3185400 dhe me Nr. Personal I11218047H, banues ne adresen Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, ne cilesine e Administratorit te shoqerise.

Ketu me poshte e quajtur "**Barredhenesi**".

Secili prej subjekteve te lartpermendur ketu me poshtë do te quhet "**Pala**" dhe bashkerisht "**Palet**".

MEQENESE

A. Barredhenesi eshte aksioner i shoqerise HEC LANABREGAS sh.a., nje shoqeri aksionare, regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer unik identifikimi te subjektit (NUIS) L41918001E, me zyre qendrore te shoqerise ne Komunen Dajt, Tirane, me kapital 192.397.676,00 (njeqind e nentedhjete e dymilione e treqind e nentedhjete e shtatemije e gjashteqind e shtatedhjete e gjashte) Leke, me perqindje pjesmarrje ne nr e aksioneve ne masen 100%, me numer aksionesh 10.000,00 ("**Shoqeria**" ose "**HEC LANABREGAS sh.a**").

B. Palet kane lidhur nje Kontrate Kredie Kufi/Overdraft me nr. rep. 2056 kol 1436 date 16/11/2022 perpiluar nga notere F. Mihilli me qellim financimin e blerjes se inventarit/kapitalit punues nga Banka, sipas kushteve dhe afateve te dakortesuara nga Palet me mundesi rinovimi pas aprovimit te Bankes me nje afat maksimal 12 mujor ne cdo rinovim ("**Kontrata e Kredise**"). Sipas Kontrates se Kredise, Banka do te levroje nje kredi me kufi/overdraft ne shumen 100,000,000(njeqind milione)Leke, te cilat do te perdoren per blerje inventari/kapital punues ("**Kredia**")

C. Ne baze te Nenit 9 te Kontrates se Kredise me kufi/overdraft, Kredimarresi e siguron Kontraten e Kredise nder te tjera me ane te garancive te meposhtme:

- Marreveshje Siguruese (mbi pengun e makinerive dhe pasijeve) Nr. 2060 Rep., Nr. 1440 Kol., date 16.11.2022 (noter/e F. Mihilli);
- Marreveshje Siguruese mbi aksione e shoqerise (HEC LANABREGAS sha) Nr. 2058 Rep., Nr. 1438 Kol., date 16/11/2022;
- Marreveshje Barre Siguruese mbi te ardhurat e arketueshme Nr. 2057 Rep., Nr. 1437 Kol., date 16/11/2022 (te UKT sha);
- Marreveshje Barre Siguruese mbi te ardhurat e arketueshme Nr. 2059 Rep., Nr. 1439 Kol., date 16/11/2022 (te HEC Lanabregas sha)
- si edhe Dorezania e ofruar nga shoqeria "HEC LANABREGAS" sha, sipas Kontrates se Kredise.

ketu me poshte quajtur "**Dokumentet e Garancise**".

D. Nenshkrimi i Marreveshjes Siguruese mbi Aksionet e HEC LANABREGAS sh.a eshte kushti paraprak i disbursimit te Kredise.

E. Palet kane shprehur vullnetin te hyjne ne kete marreveshje me qellim sigurimin e permbushjes se detyrimeve te marra persiper nga ana e "**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SH.A** ne Kontraten e Kredise Kufi/Overdraft dhe dokumentet e tjera financiare te lidhura ne kuadrin e financimit, sipas kushteve dhe afateve te kesaj Marreveshje Siguruese mbi Aksionet.

Duke konsideruar sa me lart, te cilat perbejne pjese e vullnetit dhe marreveshjes se Paleve dhe do te zbatohen si pjese e pandare e kesaj Marreveshje, Palet bien dakord per sa me poshte vijon.

I. PERKUFIZIME:

Perveç kur parashikohet ndryshe ne kete Marreveshje, ose permbajtja e saj kerkon ndryshe, shprehjet e perdorura ne Kontraten e Kredise do te kene te njejtin kuptim ne kete Marreveshje.

Gjithashtu, shprehjet e meposhtme do te kene kuptimet e meposhtme:

"Barra Siguruese"	ka kuptimin e parashikuar ne Nenin 2 te kesaj Marreveshje.
"Dite Pune"	do te thote nje dite gjate se ciles bankat jane hapur per transaksione biznesi te pergjithshem ne Tirane, Shqiperi.

"Kapitali"	do te thote ne çdo kohe, shuma totale e shlyer plotesisht e Aksioneve.
"Kolaterali"	do te thote Aksionet (te tashme dhe te ardhshme), te Drejtat e Shperndarjes dhe te Drejtat e Nenshkrimit qe i korrespondojne Aksioneve.
"Kredimarresi"	do te thote Shoqeria Kredimarrese sipas percaktimeve te Kontrates se Kredise.
"Aksione"	do te thote nje Aksion ne kapital.
"Ligji i Barreve Siguruese"	do te thote ligji i Republikes se Shqiperise nr. 8537, date 18.10.1999, i ndryshuar dhe siç mund te ndryshohet here pas here.
"Marreveshje"	do te thote marreveshja e siguruese mbi Aksionet duke perfshire Shtojcat qe jane pjese perberese e kesaj Marreveshje.
"Njoftimi i Barres Siguruese"	do te thote njoftimi per t'u bere ne Regjistrin e Barreve Siguruese.
"Njoftimi dhe Leter-Kerkesa"	do te thote njoftimi dhe kerkesa qe i jepet Shoqerise siç percaktohet ne Nenin 3.1 te kesaj Marreveshje dhe bashkangjitur sipas formes se percaktuar ne Shtojcen 1.
"Njoftimi i Rastit te Ekzekutimit"	do te thote njoftimi qe jepet nga Barremarresi sipas formes bashkangjitur kesaj Marreveshje si Shtojca 2.
"Pala/Palet"	Pala/Palet do te thote Barremarresi dhe Barredhenesit, secili prej tyre veçmas ose bashkarisht ne varesi te perdorimit dhe qellimit te dispozites perkatese.
"Periudha e Sigurimit"	Periudha e Sigurimit do te thote periudha e cila fillon ne daten e nenshkrimit te Kontrates se Kredise dhe perfundon ne kohen kur te gjithe Detyrimet e Siguruara permbushen ne menyre te plote, perfundimtare, te parevokueshme dhe te liruara ne menyre te patjetersueshme.
"Rast Ekzekutimi"	do te thote çdo Rast Mospermbushje siç percaktohet ne Kontraten e Kredise.
"Regjistri i Barreve Siguruese"	ka kuptimin qe i jepet ne Ligjin mbi Barret Siguruese

"Regjistri Tregtar"	do te thote Regjistri Tregtar i mbajtur nga Qendra Kombetare e Biznesit
"Te Drejtat e Nenshkrimit"	do te thote te gjitha te drejtat dhe pretendimet e secilit Barredhenes per te nenshkruar dhe perfituar Aksionet si pasoje e zmadhimit te kapitalit te Kredimarresit
"Te Drejtat e Shperndarjes"	do te thote te gjitha te drejtat, interesat dhe pretendimet financiare ne lidhje me Aksionet, perfshire por pa u kufizuar ne dividendet, shperndarjet e tjera perfshire por pa u kufizuar ne shperndarjet te cilat lindin si pasoje e zvogelimit te kapitalit themeltar, pretendimet mbi te ardhurat e likuidimit si dhe te gjithe pretendimet financiare te tashme apo te ardhshme te lidhura me Aksionet.

1.2 Interpretimi

1.2.1 Ne kete Marreveshje, perveçse kur percaktohet shprehimisht ndryshe, referimit te:

(a) Nje "**Pale**" i referohet çdo pale te kesaj Marreveshje, dhe "**Palet**" i referohet te gjithave paleve;

(b) Nje "**person**" perfshin çdo person fizik ose juridik shqiptar apo te huaj, ortakeri, ent shteteror ose shoqeri e thjeshte, çdo organ apo autoritet te Republikes se Shqiperise dhe perfshin trashegimtaret dhe te transferuarit e autorizuar te çdo njeres prej ketyre;

(c) Çdo Nen, paragraf ose Shtojce, me perjashtim kur shprehimisht eshte percaktuar ndryshe, i referohet Nenit, paragrafit ose Shtojces se kesaj Marreveshje;

(d) Kjo Marreveshje ose çdo dokument tjeter, kontrate ose marreveshje, perfshin nje reference ne kete Marreveshje ose cdo dokument, kontrate ose marreveshje te ndryshuar, rregulluar apo shtuar here pas here;

(e) Kjo Marreveshje i referohet kesaj Marreveshjeje se bashku me Shtojcat bashkengjitur saj; dhe

(f) Çdo ligj i Republikes se Shqiperise, statut, dekret apo dispozite ligjore perfshin çdo ligj, statut, dekret ose dispozite ligjore e cila ndryshon ose zevendeson ate duke perfshire te gjitha aktet nenligjore (duke perfshire por pa u kufizuar, çdo udhezim apo vendim te ministrise apo te çdo autoriteti tjeter kompetent) miratuar ne baze te ketij ligji, statuti dekreti apo dispozite ligjore.

1.2.2 Kur konteksi e kerkon, fjalet ne numrin njejes do te pershijne dhe ato ne shumes dhe anasjelltas, dhe fjalet qe kane nje gjini do te perfshijne te gjitha gjinite.

1.2.3 Ne rastin e nje konflikti midis dispozitave te kesaj Marreveshjeje dhe nje Shtojce te saj, do te kene perparesi dispozitat e kesaj Marreveshje mbi ato te Shtojces.

1.2.4 Titujt ne kete Marreveshje jane vetem per lehtesi referimi.

2. OBJEKTI I MARREVESHJES

2.1 Barredhenesi ne menyre te pakthyeshme dhe te pakushtezuar krijon mbi Kolateralin nje barre siguruese te rradhes se pare ne emer dhe per perfitim te Barremarresit, si garanci per permbushjen e te gjitha Detyrimeve te Siguruara. Barremarresi pranon Barren Siguruese mbi Kolateralin ne emer dhe per perfitimin te tij.

2.2 Interesat e garancise te vendosura si Kolateral ne favor te Barremarresit perfshijne te drejtat e votes lidhur me Kolateralin dhe Barredhenesi/t i jep/japin Barremarresit te drejten per te perdorur te drejten e votes sipas percaktimit te Nenit 7 (*te Drejtat e Shperndarjes*) dhe Nenit 8 (*Te Drejtat e Votes*) te kesaj Marreveshje. Palet bien dakord se te drejtat e votes lidhur me Aksionet do te ushtrohen nga Barremarresi ose Barredhenesi/t sipas rastit ne perputhje me parashikimet e Nenit 7 (*Te Drejtat e Shperndarjes*) dhe Neni 8 (*Te Drejtat e Votes*) te kesaj Marreveshje.

2.3 Deri ne kohen e ekzekutimit te Barres Siguruese, secili nga Barredhenesit do te ruaje cilesine e tij si zoterues dhe pronar i pjeses perkatese te Kolateralit.

2.4 Te gjitha te drejtat e Barremarresit sipas kesaj Marreveshje, te gjitha interesat e siguruara te krijuara me kete Marreveshje dhe te gjitha detyrimet e Barredhenesit do te jene absolute dhe vlefshmeria dhe ekzistenca e tyre jane te pavarura dhe autonome nga çdo ndryshim apo shtese e Kontrates se Kredise dhe te Dokumentave te Garancise dhe/ose nga çdo parashikim apo nga çdo detyrim i parashikuar dhe i rregulluar ne keto dokumenta.

2.5 Barra Siguruese krijohet per dhe deri ne perfundimin e Periudhes se Sigurimit. Barra Siguruese do te kete efekte te plota pavaresisht çdo garancie apo sigurimi tjeter qe mund te jete dhene apo mund te jepet ne te ardhmen ne çdo menyre nga ndonje person kundrejt Barremarresit per sigurimin e Detyrimeve te Siguruara.

3. KOMPLETIMI I BARRES SIGURUESE

3.1 Hapat specifike qe duhet te ndermerren

3.1.1 Brenda dhjete (10) Ditesh Pune nga data e leshimit te çertifikates nga Regjistri i Barreve Siguruese qe konfirmon regjistrimin e Barres Siguruese, Barremarresi do te njoftoje Barredhenesin/t mbi regjistrimin e Barres Siguruese ne Regjistrin e Barreve Siguruese dhe do t'i kerkoje nepermjet Njoftimit dhe Letres se Kerkeses ne formen e percaktuar ne Shtojcen I (*Njoftimi dhe Letra e Kerkeses*) te ndermarrin te gjithe procedurat e nevojshme per regjistrimin e Barres Siguruese ne regjistrin e aksionareve te HEC Lanabregas sha. Barredhenesi/t do te njoftoje/ne Barremarresin per kryerjen e procedurave te regjistrimit ne fjale brenda dy (2) Ditesh Pune nga marrja e Njoftimit dhe Letres se Kerkeses.

3.1.2 Brenda dy (2) Ditesh Pune nga data e kesaj Marreveshje, Barredhenesi/t do te aplikoje/ne per regjistrimin e Barres Siguruese dhe te kesaj Marreveshje ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) nepermjet depozitimit te Njoftimit te Barres ne menyre qe Barra Siguruese te regjistrohet si barre e rradhes se pare sipas parashikimeve te ligjit shqiptar.

3.1.3 Barredhenesi/t do te njoftoje/ne dhe do t'i dergoje/ne Barremarresit çertifikaten e kryerjes se regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB) brenda nje (1) Dite Pune nga data e marrjes se çertifikates se regjistrimit te leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) (ekstraktit te QKB).

3.2 Hapat e tjere qe duhet te ndermerren

Pa cenuar nenin 3.1 (*Hapat specifike qe duhet te ndermerren*) Barredhenesi/t merr/marrin persiper, ne menyre te parevokueshme dhe te pakushtezuar, qe sipas rastit te nenshkruaje/ne, te dorezoje/ne, te regjistroje/ne dhe te depozitoje/ne ne (i) Regjistrin e Barreve Siguruese, (ii) regjistrin e aksionareve te HEC Lanabregas sh.a dhe (iii) Regjistrin Tregtar çdo dokument per krijimin, vlefshmerine, realizimin ose perparesine, ruajtjen dhe mbrojtjen e Barres Siguruese sipas kerkesave te Barremarresit, ne nje forme dhe permbajtje te pranueshme per Barremarresin dhe ne emer e per llogari te Barremarresit do te marre/in rregullisht origjinalet e nenshkruara apo kopjet e noterizuara, se bashku me çdo dokument, regjistrim, depozitim, njoftim, noterizim ose çdo deshmi tjeter te kerkuar ne baze te opinionit te Barremarresit ne menyre qe te realizoje qellimet e kesaj Marreveshje si dhe per krijimin, vlefshmerine, realizimin ose perparesine, ruajtjen dhe mbrojtjen e Barres Siguruese mbi Kolateralin.

4. Barra Siguruese mbi Aksionet e Ardhshme

Barredhenesi/t angazhohen te permbushin çdo dhe te gjitha detyrimet e percaktuara ne Nenet 3.1, dhe 3.2 ne lidhje me Aksionet e emetuara gjate Periudhes se Sigurimit.

5. NDODHJA E RASTIT TE EKZEKUTIMIT

5.1 Barredhenesi/t, me nenshkrimin e kesaj marreveshje, jep/japin miratimin e tij/tyre te shprehur qe pas ndodhjes se nje Rasti Ekzekutimi Barremarresi ka te drejte qe nese e gjykon dhe per aq sa lejohet nga legjislacioni i zbatueshem (duke perfshire te gjitha periudhat perkatese ne perputhje me nenet 35 dhe 37 te Ligjit per Barret Siguruese), pa njoftime te metejshme per Barredhenesin/t ose autorizim paraprak nga gjykatat, te ekzekutoje te gjitha ose çdo pjese te garancise te perbere nga Barra Siguruese, ne çdo menyre qe e gjykon te pershtatshme, duke perfshire por pa u kufizuar ne ushtrimin e çdo te drejte sipas kesaj Marreveshje.

5.2 Pa cenuar Nenin 5.1 me lart, pas marrjes dijeni mbi ndodhjen e Rastit te Ekzekutimit ne perputhje me percaktimet e parashikuara ne Kontraten e Kredise dhe ne kete Marreveshje, Banka do te njoftoje me shkrim Barredhenesin sipas formes se percaktuar ne Shtojcen 2.

5.3 Me ndodhjen e nje Rasti Ekzekutimi, Barremarresi ka te drejte, pervec sa parashikohet ne ndonje dispozite tjeter te kesaj Marreveshje:

(a) te bllokoje, mbledhe, realizoje, transferoje, çliroje ndaj paleve te treta, ose te disponoje Kolateralin ose çdo pjese te tij, ne menyra te tjera ne perputhje me kushtet dhe afatet e Ligjit per Barret Siguruese; dhe mund te ngarkoje/per llogari te tij dhe te paguaje shumat per shpenzimet e kryera ne lidhje me sherbimet e bllokimit, mbledhjes, realizimit, shitjes ose marrjes se pageses per Kolateralin dhe mund t'i shtoje keto shuma ne borxhin e Shoqerise dhe/ose Barredhenesit/ve ndaj Barremarresit;

(b) te procedoje me ekzekutimin e pageses dhe ushtrimin e çdo te drejte dhe mjeti te Barremarresit te parashikuar nga Ligji per Barret Siguruese, si edhe çdo te drejte dhe mjet tjeter ne dispozicion te Barremarresit dhe qe nuk ndalohen nga ligji shqiptar; dhe

(c) t'i kerkoje Barredhenesit/ve qe me marrjen e kerkeses se Barremarresit, te transferoje ose cedoje Kolateralin, teresisht ose pjeserisht tek çdo pale e trete.

5.4 Pas ndodhjes se nje Rasti Ekzekutimi, Barredhenesi/t jep/japin miratimin e tyre te shprehur se Barremarresi do te kete te drejte te mbledhe dhe marre nga Barredhenesi menjehere pa ndermarre veprime te metejshme gjyqesore, pagesat e dividendeve, Te Drejtat e tjera te Shperndarjes si dhe shuma te tjera te pagueshme ne lidhje me Aksionet deri ne masen qe keto pagesa/shlyerje te te Drejtave te Shperndarjes kerkohen me qellim permbushjen e Detyrimeve te Siguruara. Pas ndodhjes se nje Rasti Ekzekutimi, Barredhenesi/t do te siguroje/ne se "Shoqeria" nuk do t'i realizoje atyre pagesa te tilla qe prekin dividendet, te Drejtat e Shperndarjes ose vlera te tjera parash te kerkueshme ne lidhje me Aksionet.

5.5 Barredhenesi/t, me shpenzimet e veta do te jape/in dhe do te siguroje/ne qe dhe "Shoqeria" do te jape te gjithe ndihmen dhe asistencen e nevojshme per te lehtesuar dhe realizuar ekzekutimin e Barres Siguruese.

6. PERDORIMI I TE ARDHURAVE

Te ardhurat nga ekzekutimi i Barres Siguruese do t'i paguhen Barremarresit dhe do te perdoren me qellim permbushjen e Detyrimeve te Siguruara ne perputhje me Kontraten e Kredise. Çdo e ardhur nga ekzekutimi apo shume tjeter e marre nga Barremarresi, ne tejkalim te shumes se Detyrimeve te Siguruara do t'i kaloje Barredhenesit.

7. TE DREJTAT E SHPERNDARJES

7.1 Periudha deri ne ndodhjen e Rastit te Ekzekutimit

7.1.1 Perpara ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit secili nga Barredhenesit do te ushtroje te drejtat e votes ne lidhje me shperndarjet dhe do te udhezoje organin ekzekutiv te Kredimarresit per te disponuar te Drejtat e Shperndarjes ne çdo rast ne perputhje me kushtet e Kontrates se Kredise dhe sidomos kufizimet e percaktuara ne Kontraten e Kredise.

7.1.2 Per shmangien e çdo dyshimi, gjate Periudhes se Sigurimit, te drejtat e votes lidhur me Shperndarjet do te ushtrohen nga secili Barredhenes ne menyre te tille qe mos te merret asnje vendim apo veprim ne lidhje me funksionimin e "Shoqerise" i cili (i) nuk do te ishte ne perputhje me kete Marreveshje, (ii) do te ndikonte negativisht vlefshmerine apo ekzekutimin e Barres Siguruese, (iii) nuk do te ishte ne perputhje ose do te vinte ne kundershtim me parashikimet e Kontrates se Kredise, Marreveshjes se Drejtperdrejte ose (iv) do te pengonte ushtrimin e te drejtave te Barremarresit te cilat lindin nga ose ne lidhje me kete Marreveshje.

7.2 Periudha pas ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit

Pas ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit, Barredhenesi/t:

7.2.1 nuk do te kete/kene me te drejte te marre/in ose te mbaje/ne te Drejta Shperndarje dhe secili nga Barredhenesit me ane te kesaj Marreveshje autorizon ne menyre te parevokueshme Barremarresin dhe njofton me shkrim per kete qellim "Shoqerine", qe Barremarresi te udhezoje organin ekzekutiv te "Shoqerise" te mos disponoje asnje nga te Drejtat e Shperndarjes, pa miratimin paraprak me shkrim te Barremarresit; dhe

7.2.2 nese dividendet ose pagesat apo shumat e tjera te parave ne lidhje me Aksionet jane marre nga ndonje nga Barredhenesit, Barredhenesi/t do te mbaje/ne keto dividende, pagesa apo shumat e tjera te parave ne mirebesim per perfitim te Barremarresit, si dhe do t'i veçojne keto dividende, pagesa apo shuma te tjera te parave nga asetet, pronat ose fondet e tjera te Barredhenesit dhe do te paguajne menjehere ose dorezojne (sipas rastit) keto dividende, pagesa dhe shuma te tjera ne favor te Barremarresit me qellim mbajtjen e tyre si garanci per permbushjen e Detyrimeve te Siguruara.

8. TE DREJTAT E VOTES

8.1 Periudha perpara ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit

8.1.1 Perpara ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit secili nga Barredhenesit, ka te drejte te ushtroje te gjitha te drejtat e votes lidhur me Aksionet te cilat i zoteron ne perputhje me kushtet dhe afatet e percaktuara ne kete Marreveshje, perfshire te drejtat e votes mbi Shperndarjet, ne çdo rast sipas kushteve te parashikuara ne Kontraten e Kredise.

8.1.2 Gjate kohezgjatjes se Periudhes se Sigurimit, te drejtat e votes do te ushtrohen ne menyre te tille qe mos te merret asnje vendim i cili (i) nuk do te ishte ne perputhje me kete Marreveshje, (ii) do te ndikonte negativisht vlefshmerine apo ekzekutimin e Barres Siguruese, (iii) nuk do te ishte ne perputhje ose do te vinte ne kundershtim me parashikimet e Kontrates se Kredise dhe te Marreveshjes se Drejtperdrejte ose (iv) do te pengonte ushtrimin e te drejtave te Barremarresit te cilat lindin nga ose ne lidhje me kete Marreveshje.

8.1.3 Veçanerisht, Barredhenesi/t nuk do te marre/in asnje vendim ose veprime te cilat do te ndikonin "Shoqerine" te mos marre vendime ose ndermarre veprime te cilat lidhen me likuidimin, zvogelimin e kapitalit themeltar, bashkimin, ndarjen, shnderrimin, krijimin e nje shoqerie te re ose ristrukturime te tjera te "Shoqerise" pa miratimin paraprak me shkrim te Barremarresit.

8.2 Periudha pas ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit

8.2.1 Me ane te kesaj Marreveshje secili Barredhenes jep miratimin e tij te shprehur se pas ndodhjes se nje Rasti Ekzekutimi, secili Barredhenes do te votoje sipas udhezimeve dhe pas miratimit te Barremarresit.

9. PERFUNDIMI I TE DREJTAVE TE BARREMARRESIT

Pas perfundimit te Periudhes se Sigurimit Barra Siguruese e krijuar me ane te kesaj Marreveshje do te perfundoje dhe te gjitha te drejtat e lidhura me Kolateralin do te kalojne tek Barredhenesi/t. Pas perfundimit te Periudhes se Sigurimit, Barremarresi me shpenzimet e Barredhenesit/ve do te

nenshkruaje dhe do t'i dorezoje Barredhenesit/eve te gjitha dokumentat qe Barredhenesit do te kerkojne ne menyre te arsyeshme per te provuar perfundimin e Barres Siguruese.

10. PERFAQESIMET DHE GARANCITE

Pa cenuar, dhe ne vijim te deklarimeve dhe garancive te percaktuara ne Kontraten e Kredise, Barredhenesit, ne daten e kesaj Marreveshjeje, deklarojne dhe garantojne Barremarresin, si me poshte:

(a) Nuk ekziston asnje barre mbi Kolateralin, me perjashtim te Barres Siguruese dhe te drejtat e paleve te treta te preferuara me ligj;

(b) Barra Siguruese eshte vendosur dhe krijuar rregullisht nga secili Barredhenes dhe te gjitha detyrimet sipas kesaj Marreveshje perbejne detyrime te vlefshme dhe detyruese te Barredhenesit/ve dhe jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar;

(c) Vendosja, krijimi dhe kompletimi i Barres Siguruese si dhe parashikimet e perfshira ne kete Marreveshje nuk jane ne kundershtim me ndonje ligj shqiptar apo dokument detyrues per Barredhenesin/t;

(d) Me perjashtim te garancive te krijuara sipas kesaj Marreveshje, Barredhenesi/t vecmas dhe se bashku, kane te drejta te plota dhe te pakufizuara ligjore si dhe eshte/jane zoterues/it i/e vetem dhe ligjore te Kolateralit te lire nga çdo barre siguruese apo garanci tjeter, peng apo çdo e drejte e paleve te treta dhe nuk do t'i nenshtrohet/n ne te ardhmen ndonje konfiskimi, pengu apo i ndonje te drejte tjeter te paleve te treta;

(e) Nuk ka pretendime apo procedime te cilat jane ne proces/pezull apo qe mund te paraqiten prane ndonje gjykate apo nje paneli arbitrazhi ne Republiken e Shqiperise ose jashte saj, ne lidhje me Kolateralin;

(f) Detyrimet e Siguruara si dhe parashikimet e perfshira ne kete Marreveshje nuk jane ne kundershtim me ndonje marreveshje apo angazhim tjeter, ku secili nga Barredhenesit eshte pale apo me ndonje dispozite te ligjit apo dokument tjeter detyrues per Barredhenesin/t;

(g) Barredhenesi garanton se ka ndermarre te gjitha veprimet e tjera te nevojshme per lidhjen dhe permbushjen e detyrimeve sipas kesaj Marreveshje dhe nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Marreveshje eshte autorizuar rregullisht nga Asambleja e Shoqerise, aksionet e te ciles Barredhensi po barreson ne favor te Kredidhenesit;

(h) Lidhja e kesaj Marreveshje nga Barredhenesi dhe permbushja e detyrimeve te tij sipas Marreveshjes nuk shkel apo bie ne kundershtim me, apo nuk tejkalon kufijte e vendosur nga:

(i) çdo ligj i zbatueshem per te;

(ii) akti i themelimit apo statuti apo çdo dokument tjeter themelues; ose

(iii) çdo marreveshje apo dokument detyrues per te apo per asetet e tij apo qe perben nje rast mosperbushjeje apo perfundimi (sido qe te pershkruhet) ne baze te asaj marreveshje apo dokumenti;

(i) te gjitha autorizimet e nevojshme dhe/ose lejet qe mundesojne dhe i japin te drejta Barredhenes per te lidhur kete Marreveshje jane marre dhe jane ne fuqi dhe efekt te

plote dhe do te vazhdojne te qendrojne ne fuqi dhe efekt te plote gjate gjithe periudhes se ekzistences se kesaj Marreveshje; dhe

(j) kjo Marreveshje perben nje detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Barredhenesin dhe eshte nje sigurim efektiv mbi Kolateralin dhe mbi çdo pjese te tij ne perputhje me kete Marreveshje dhe perben nje barre siguruese te rradhes se pare te ekzekutueshme mbi Kolateralin.

11. ANGAZHIMET E BARREDHENESVE

Gjate afatit te Periudhes se Sigurimit, ose perveç rastit kur Barremarresi bie dakord ndryshe, Barredhenesi/t:

(a) nuk do te ndermarrin ndonje veprim i cili:

(i) mund te cenoje drejtperdrejte apo terthorazi vlefshmerine, efektshmerine apo ekzekutueshmerine e Barres Siguruese apo te te drejtave dhe interesave te Barremarresit sipas Kontrates se Kredise; ose

(ii) mund te cenoje vlefshmerine apo ekzistencen e Kontrates se Kredise apo te drejtat e Barremarresit sipas Kontrates se Kredise.

(b) do te ndermarrin, me shpenzimet e tyre, te gjitha veprimet qe mund te jene te nevojshme dhe ne menyre te arsyeshme te keshillueshme per te mbrojtur vlefshmerine, efektshmerine dhe ekezekutueshmerine e Barres Siguruese apo te drejtat e Barremarresit, duke perfshire ato kunder pretendimeve te paleve te treta;

(c) me shpenzimet e tyre do te nenshkruajne dhe dorezojne menjehere te gjitha dokumentet dhe do ndermarrin te gjitha veprimet qe mund te jene te nevojshme ose te keshillueshme me qellim qe:

(i) te regjistroje, permbushe dhe mbaje ne fuqi dhe efekt te plote Barren Siguruese; dhe

(ii) mundesoje ushtrimin nga ana e Barremarresit te te drejtave dhe mjeteve juridike qe ai gezon ne baze te kesaj Marreveshjeje, duke perfshire pa u kufizuar, ne ushtrimin e te gjitha te drejtave dhe mjeteve juridike te ushtrueshme me ndodhjen e nje Rasti Ekzekutimi ne kufijte dhe ne menyren e lejuar nga ligji i zbatueshem.

(d) te mos krijoje/ne apo lejojne krijimin e ndonje barre, interesi te siguruar apo çdo barre apo pengese tjeter ose ekzistencen e ndonje te drejte te paleve te treta mbi nje pjese apo mbi te gjithe asetet e ardhshme, perfshire Kolateralin, me perjashtim te Barres Siguruese dhe interesat e siguruara te krijuara ne lidhje me kete Barre Siguruese;

(e) te demshperbleje/ne Barremarresin dhe te mbajne ate te pacenuar nga çdo dhe te gjitha kerkesat, pretendimet dhe padite e ngritura dhe/ose te paraqitura nga palet e treta, te cilat lidhen me mbajtjen e Barres Siguruese nga Barremarresi;

(f) te nenshkruajte/ne, te pranojne dhe te dorezojne, detyrat, transferimet, dhe dokumente te tjera, te cilat mund te kerkohen ne menyre te arsyeshme nga Barremarresi, me qellim per t'i dhene fuqi kesaj Marreveshjeje dhe te paguaje te gjitha shpenzimet per kerkimet, regjistrimet dhe depozitimet;

(g) te dorezoje/ne menjehere tek Barremarresi te gjitha njoftimet dhe dokumentet e tjera te perfituara ne lidhje me Kolateralin, perfshire ketu por pa u kufizuar, pretendimet e paleve te treta; dhe

(h) te mos shese/in, transferoje/ne, apo ndryshe disponoje/ne Kolateralin perveç kur Banka jep miratimin e saj paraprak me shkrim.

12. DEMSHPERBLIMI, TAKSAT, KOSTOT DHE SHPENZIMET

12.1 Pergjegjesia per Barremarresin

Barremarresi nuk do te jete pergjegjes per humbjet ose demet e pesuara nga Barredhenesi/t per shkak te ndonje interesi sigurie te percaktuar ne kete Marreveshje, te realizimit te te drejtave te Barremarresit ose ushtrimit ose pamundesise se ushtrimit nga Barremarresi, te te drejtave, veprimeve apo mjeteve juridike, per te cilat ky i fundit ka te drejte sipas kesaj Marreveshje perveç rasteve kur humbja ose demi eshte shkaktuar nga dashja apo pakujdesia e rende e Barremarresit.

12.2 Taksat

12.2.1 Barredhenesi/t do te paguaje/ne te gjitha taksat e pulles, regjistrimit si dhe taksat e tjera dhe çdo detyrim tjeter publik ndaj te cilave kjo Marreveshje dhe/ose garancite e parashikuara nga kjo Marreveshje jane ose mund te jene subjekt (duke perfshire, por pa u kufizuar ne, çdo takse pulle, tarife regjistrimi ne gjykate dhe tarifa noteri, te cilat do behen te kerkueshme dhe te pagueshme ne lidhje me lidhjen, regjistrimin, nenshkrimin, zbatimin dhe ekzekutimin e kesaj Marreveshje) dhe do te demshperbleje/ne, kohe pas kohe, Barremarresin sipas kerkeses per çdo detyrim, kosto, pretendim dhe shpenzim qe mund te rezultoje per shkak te deshtimit per te paguar apo voneses ne pagesen e ndonjeres nga keto taksa.

12.2.2 Nese keto taksa apo detyrime te tjera publike i ngarkohen Barremarresit, Barredhenesi/t do te kompensoje/ne menjehere Barremarresin per te gjitha keto detyrime (dhe ne çdo rast brenda pese (5) Ditesh Pune) pasi te kene marre nga Barremarresi, kerkesen perkatese te shoqeruar me fature ose dokument tjeter qe verteton ne menyre te arsyeshme pagesen e kryer nga Barremarresi.

12.3 Shpenzimet e Ekzekutimit

Barredhenesi/t, brenda pese (5) Ditesh Pune nga kerkesa, do t'i paguaje/ne Barremarresit, shumen e te gjitha kostove dhe shpenzimeve (duke perfshire tarifat ligjore dhe noteriale) te kryera nga Barremarresi ne lidhje me ekzekutimin e Barres Siguruese apo ruajtjen e ndonje prej te drejtave sipas kesaj Marreveshjeje dhe Barredhenesit do te demshperbleje/ne dhe do te mbaje/ne Barremarresin te pacenuar nga keto kosto dhe shpenzime.

12.4 Demshperblimi

Barredhenesi/t do te demshperbleje/ne menjehere Barremarresin per çdo kosto, humbje ose detyrim te shkaktuar si rezultat i:

(a) marrjes, mbajtjes dhe mbrojtjes se Barres Siguruese;

(b) ushtrimit te ndonje prej te drejtave/kompetencave, diskrecionit dhe mieteve ligjore te Barremarresit te garantuara nga kjo Marreveshje apo nga ligji; ose

(c) çdo vonese e Barredhenesve ne permbushjen e detyrimeve te shprehura qe do te mbarten prej tij ne kete Marreveshje,

perveç kur kjo kosto, humbje apo detyrim ka ardhur si pasoje e pakujdesise se rende apo dashjes se pales se demshperblyer.

12.5 Pagesat e pazbritshme

Te gjitha pagesat qe do te kryhen ndaj Barremarresit sipas kesaj Marreveshje do te kryhen te lire nga dhe pa zbritje per ose ne llogarine e taksave, perveç kur Barredhenesi/t eshte/jane te detyruar te kryeje/ne keto pagesa objekt i zbritjes ose mbajtjes ne burim te taksave, dhe ne nje rast te tille shuma e pagueshme nga Barredhenesi/t ne lidhje me te cilen kerkohet te behet kjo zbritje apo mbajtje ne burim, do te rritet aq sa eshte e nevojshme per te siguruar se, pasi te kryhet zbritja ose mbajtja ne burim, personi per llogari te te cilit si detyrim tatimor kjo zbritje ose mbajtje ne burim eshte kryer, te marre dhe te mbaje (te lire nga çdo detyrim ne lidhje me kete zbritje apo mbajtje ne burim) nje shume neto te barabarte me shumen te cilen do te kishte marre dhe per rrjedhoje mbajtur nese kjo zbritje apo mbajtje ne burim nuk do te ishte aplikuar ose nuk do te ishte kerkuar te kryhej.

Demshperblimet e parashikuara ne kete Marreveshje nuk do te cenojne te drejtat e Barremarresit sipas ndonje Dokumenti Garancie.

13. NJOFTIMET

13.1 Komunikimet me shkrim

13.1.1 Te gjitha njoftimet apo komunikimet e tjera te kryera sipas kesaj ose ne lidhje me kete Marreveshje do te kryhen me shkrim dhe, perveç kur parashikohet ose kerkohet ndryshe nga ligji, mund te kryhen me faks. Çdo njoftim i tille do te konsiderohet i dhene:

(a) nese nepermjet faksit, kur faksi eshte marre nga marresi ne forme te lexueshme, me kusht qe nje njoftim i marre jo ne Dite Pune do te konsiderohet te jete dhene ne diten tjeter te Dites se Punes; dhe

(b) nese nepermjet shkreses, kur eshte lene ne adresen perkatese ose pese (5) Dite Pune pasi te jete depozituar ne kutine postare te postes ne nje zarf te parapaguar adresuar ne ate adrese.

13.1.2 Megjithate, çdo njoftim Rasti Ekzekutimi do te jepet edhe nepermjet postes rekomande dhe do te kete efekte ne momentin e dorezimit.

13.1.3 Çdo njoftim apo komunikim per t'u kryer apo derguar tek Barremarresi do te kete efekte vetem pasi te jete marre nga Banka dhe vetem nese eshte shenuar shprehimisht per vemendje te departamentit apo zyrtarit te identifikuar me Barremarresin, dhe nenshkruar ne fund.

13.2 Adresat

Perveç kur parashikohet ndryshe, te gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera sipas kesaj Marreveshje do te dergohen dorazi ose me poste rekomande, faks ose korrier te shpejte,

marresve perkates ne adresen e tyre te percaktuar ne kete Marreveshje ose ne nje adrese tjeter qe do te ofrohet nga Palet per kete qellim nepermjet nje njoftimi me shkrim jo me pak se pese (5) Dite Pune, perveç kur ligji i zbatueshem parashikon ndryshe.

(a) Nese i drejtohet Barredhenesit/ve:

[.....]

(b) Nese i drejtohet Barremarresit:

[.....]

13.3 Ditet e Pushimit

Njoftimi ose komunikimi i marre ne nje dite tjeter e cila nuk eshte Dite Pune ose pas oreve normale te punes ne shtetin marres, do te konsiderohet sikur eshte marre ne Diten vijuese te Punes.

14. LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

14.1 Ligji i Zbatueshem

Kjo Marreveshje do te rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise.

14.2 Juridiksioni

Gjykata e Rrethit Tirane do te kete juridiksionin per zgjidhjen e mosmarreveshjeve qe mund te lindin midis Paleve ne lidhje me kete Marreveshje, ne rast se keto mosmarreveshje nuk zgjidhen ne menyre miqesore midis Paleve.

15. DISPOZITA TE NDRYSHME

15.1 Ndryshime dhe Heqje Dore

Asnje ndryshim ose heqje dore ndaj dispozitave te kesaj Marreveshje nuk do te kete efekte perveç nese eshte kryer me miratimin me shkrim te Barredhenesit/ve dhe Barremarresit.

15.2 Modifikimi, Transferimi, Zevendesimi

15.2.1 Kjo Marreveshje do te jete e detyrueshme dhe do te sherbeje ne perfitim te Barremarresit pavaresisht ndonje modifikimi, ose transferimi apo zevendesimi te Kontrates se Kredise ose kesaj Marreveshje.

15.2.2 Secili Barredhenes:

(a) Hie dakord shprehimisht lidhur me vazhdimesine e Barres Siguruese ne rast te zevendesimit te pjesshem apo teresqnte Detyrimeve te Sigurimit; dhe

(b) merr persiper te konfirmoje me shkrim, nese kjo kerkohet nga Barremarresi ne ose perpara modifikimit, transferimit apo zevendesimit te Kontrates se Kredise ose transferimit te Detyrimeve te Siguruara, miratimin e tij per kete vazhdimesi.

15.3 Interes i Vazhdueshem

Barra Siguruese e krijuar nga kjo Marreveshje do te jete detyruese per Barredhenesit, trashegimtaret e tij dhe pasardhesit e tij, dhe do te qendroje ne fuqi dhe efekt te plote, dhe do te perbeje dhe do te jete nje sigurim i vazhdueshem pavaresisht pagesave ose permbushjes se pjesshme te Detyrimeve Siguruese, dhe nuk do te cenohet ose preket ne asnje menyre nga, barre te tjera, detyrime per demshperblim ose garanci te dhena nga Barredhenesi/t ne perfitim te ndonje pale tjeter ose vendim apo urdher i marre nga Barremarresi ne lidhje me ndonje nga Detyrimet e Siguruara.

12.4 Transferimi

Asnje nga Barredhenesit nuk do te transferoje, teresisht ose pjeserisht, ndonje prej te drejtave te tij sipas kesaj Marreveshje pa miratimin paraprak me shkrim te Barremarresit.

12.5 Kompensime te Akumuluara

Te gjitha te drejtat, veprimet dhe kompensimet e Barremarresit sipas kesaj Marreveshje i shtohen dhe nuk perjashtojne ndonje te drejte, veprim apo kompensim tjeter sipas te cilit Barremarresi gezon te drejta ne perputhje me ndonje kontrate (duke perfshire, pa u kufizuar ne Kontraten e Kredise) ose sipas ligjit.

12.6 Interes i Siguruar i Ndare

Palet nepermjet kesaj Marreveshje pranojne shprehimisht dhe konfirmojne se Barra Siguruese eshte e ndare nga, dhe nuk lidhet me, ndonje interes tjeter te siguruar qe i eshte dhene ose do t'i jepet Barremarresit nga Barredhenesi/t per te siguruar permbushjen e detyrimeve te Barredhenesit/ve sipas Kontrates se Kredise. Palet ne kete Marreveshje bien dakord qe Barremarresi mund te ushtroje te drejtat e tij sipas kesaj Marreveshjeje, pavaresisht te drejtave te tij sipas ndonje interesi tjeter te siguruar qe siguron permbushjen e detyrimeve te Barredhenesit/ve sipas Kontrates se Kredise.

12.7 Ndashmeria e Dispozitave

Dispozitat qe permban çdo nen dhe paragraf i kesaj Marreveshje do te jene te zbatueshme ne menyre te pavarur nga njera-tjetra dhe vlefshmeria e tyre nuk do te cenohet nese ndonje dispozite tjeter eshte e pavlefshme. Nese ndonje nga dispozitat eshte e pavlefshme por do te kishte qene e vlefshme nese ndonje pjese e dispozites do te fshihej, dispozita ne fjale do te aplikohet me modifikimet e nevojshme qe e bejne ate te vlefshme.

12.8 Kopje

Kjo Marreveshje eshte hartuar ne 5, kopje origjinale ne gjuhen shqipe, secila me vlere te njejte.

Une, i nenshkruari Noteri, u lexova Paleve sa me siper dhe u shpjegova atyre efektet ligjore te çdo dispozite te kesaj Marreveshje.

Palet ne kete Marreveshje, me deklarojne se e kane kuptuar permbajtjen e ketij dokumenti dhe konfirmojne qe kjo permbajtje perputhet plotesisht me deklarimet dhe kuptimet e tyre dhe oto me vullnet te plote synojne ekzaktesisht ato efekte ligjore. Palet konfirmojne vullnetin e tyre te lire ne pranimin dhe bien dakord per sa mesiper duke nenshkruar rregullisht kete Marreveshje ne pranine time.

Une, Noteri, vertetoj gjithe sa me siper duke nenshkruar dhe vulosur te njejtin dokument.

PALET

BARREMARRESI

BANKA KOMBETARE TREGTARE SHA

Perfaqesuar nga:

Z. Erion Hoxha

Zni. Elvira Proda

BARREDHENESI:

"UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SH.A

Perfaqesuar nga:

Z. Elton Kacidhja

NOTERE
FLORA MHILLI
NUIS: L61620041M
TIRANE

SHTOJCA 1

FORMA NJOFTIMIT DHE LETRA KERKESES

Per: **Kredimarresin** BKT Sh.a.

[Adresa]

Ne vemendje te: **Barredhenesit/ve** UKT Sh.a.

[Adresa]

I referohemi Marreveshjes Siguruese mbi Aksionet date 16.11 2022 ("**Marreveshja**") te lidhur midis Shoqerise "UJËSJELLËS KANALIZME TIRANË" sh.a si **Barredhenesi** dhe Bankes Kombetare Tregtare si **Barremarresi** ("**Marreveshja**"). Fjalet me shkronja te medha te perdorura ne kete Leter do te kene te njejtin kuptim sipas Marreveshjes Siguruese mbi Aksionet.

Me ane te ketij Njoftimi dhe Leter Kerkese kerkojme qe te regjistrohet Barra Siguruese mbi Aksionet ne Regjistrin e Aksionareve te mbajtur nga Kredimarresi dhe ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Nderime,

(Banka)

Nga: Erion Hoxa

Pozicioni: Drejtor Dege

Nenshkrimi:

BANKA KOMBETARE TREGTARE Sh.a. BKT DEGA RI ELBASANIT

SHTOJCA 2

NJOFTIMIT I RASTIT TE EKZEKUTIMIT

Per: **Barredhenesin/t** BKT sha.

[Adresa]

Ne vemendje te: **Kredimarresit** UKT sha.

[Adresa]

I referohemi Marreveshjes Siguruese mbi Aksionet date 16.11.2019 ("**Marreveshja**") te lidhur midis Shoqerise "UJËSJELLËS KANALIZME TIRANË" sh.a si **Barredhenes/it** dhe Bankes Kombetare Tregtare Sha. si **Barremarresi ("Marreveshja")**. Fjalet me shkronja te medha te perdorura ne kete Leter do te kene te njejtin kuptim sipas Marreveshjes Siguruese mbi Aksionet.

Me ane te kesaj Letre ju njoftojme se ka ndodhur nje Ngjarje Mospermbushje. Banka ka ndjekur te gjitha procedurat e parashikuara ne Kontraten e Kredise per te kerkuar ekzekutimin e e Barres Siguruese dhe kjo leter perben Njoftimin e Rastit te Ekzekutimit te percaktuar ne Nenin 5.2 te Marreveshjes.

Ne perputhje me Nenin 7.2 (*Periudha pas Ndodhjes se Rastit te Ekzekutimit*) te Marreveshjes, pagesa e dividendeve, te Drejtat e tjera te Shperndarjes si dhe shumat e tjera te parave te paguara ose te kerkueshme ne lidhje me Aksionet e Barredhenesve do te kryhen sipas te dhenave me poshte:

[.....]

Nderime,

Banka Kombetare Tregtare Sha

Nga:

Pozicioni:

Nenshkrimi:

UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË sha

UKT

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SHA
AKSIONARI I VETËM I SHOQËRISE "HEC LANABREGAS" SHA

VENDIM

Nr.23 Datë 01 / 11 / 2022

PËR :

MIRATIMIN E DHËNIES SË DORËZANISË NGA SHOQËRIA HEC LANABREGAS SH.A DHE NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJEVE SIGURUESE DHE KONTRATËS TË HIPOTEKIMIT PËR KREDINË BANKARE QË UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A DO TË MARRË PRANË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE SHA.

Në mbështetje të neneve 127,128, 135 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, në nenin 12 të Statutit të HEC Lanabregas sh.a, në Vendimin Nr.538 prot., datë 25.10.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të UKT sh.a, si edhe në memo-n Nr. 4238 Prot, datë 27.10.2022, në cilësinë e përfaqësuesit të aksionerit të vetëm të kësaj shoqërie,

VENDOSI:

1. Miratimin që pronat si më poshtë vijonë të vazhdojnë të qëndrojnë të bllokuara në favor të Bankës Kombëtare Tregtare sha duke garantuar edhe shtesën e limit të ri të kredisë me kufi/ Overdraft në shumën 100,000,000 (njëqind milion) ALL që do të merret nga ana e shoqërisë UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SHA, në total Limit i ri i kredisë me kufi/ Overdraft bëhet 950,000,000 (nëntëqind e pesëdhjetë milion) ALL:
   - *Truall dhe Ndërtese, me sipërfaqe trualli 2,276 m2 dhe ndërtese 270m2, regjistruar me numër pasurie 87/42, në Zonën Kadastrale 2380, Vol.5, Faqe 217, Kod Unik 2380005217, me adresë Dajt- Lanbregas- Tiranë.*
   - *Truall me sipërfaqe 1,114 m2, regjistruar me nr. pasurie 75/34, Zona Kadastrale 2380, Vol.2, Faqe 127, Kod Unik 2380002127, adresë në Dajt- Lanbregas- Tiranë.*

2. Miratimin e dhënies së Dorëzanesise nga shoqëria HEC Lanabregas sh.a duke garantuar limitin e ri të kredisë me kufi/ Overdraft në shumën 950,000,000 (nëntëqind e pesëdhjetë milion) ALL *(përfshirë limitin ekzistues dhe shtesën e limit të ri të kredisë me kufi/ Overdraft)* që do të merret nga ana e shoqërisë UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SHA dhe të akorduara nga ana e "Bankës Kombëtare Tregtare" sha për shoqërinë "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" sha.

3. Miratimin e barrësimit dhe lënies peng të Makinerive dhe Pajisjeve, Automjeteve të shoqërisë HEC Lanabregas sh.a duke garantuar limitin e ri të kredisë me kufi/ Overdraft në shumën 950,000,000 (nëntëqind e pesëdhjetë milion) ALL *(përfshire limitin ekzistues dhe shtesën e limit të ri të kredise me kufi/ Overdraft)* që do të merret nga ana e shoqërisë UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SHA dhe të akorduara nga ana e "Bankës Kombëtare Tregtare" sha për shoqërinë "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" sha.

4. Miratimin e barrësimit në formën e kuotave të shoqërisë HEC Lanabregas sh.a duke garantuar limitin e ri të kredisë me kufi/ Overdraft në shumën 950,000,000 (nëntëqind e pesëdhjetë milion) ALL *(përfshirë limitin ekzistues dhe shtesën e limit të ri të kredisë me kufi/ Overdrafte)* që do të merret nga ana e shoqërisë UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SHA dhe të akorduara nga ana e "Bankës Kombëtare Tregtare" sha për shoqërinë "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" sha

5. Miratimin e barrësimit në formën e Pengut të të Ardhurave të Arkëtueshme, të të ardhurave të shoqërisë HEC Lanabregas sh.a që do të rrjedhin nga shitja e energjisë elektrike për KESH sh.a apo subjekte të treta nëpërmjet Bankës, duke garantuar limitin e ri të kredisë me kufi/ Overdraft në shumën 950,000,000 (nëntëqind e pesëdhjetë milion) ALL *(përfshirë limitin ekzistues dhe shtesën e limit të ri të kredisë me kufi/ Overdraft)* që do të merret nga ana e shoqërisë UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SHA dhe të akorduara nga ana e "Bankës Kombëtare Tregtare" sha për shoqërinë "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" sha.

6. Autorizimin e Administratorit të shoqërisë HEC Lanabregas sha të nënshkruajë Kontratën e kredisë (me Kufi/ Overdrafte) dhe Marrëveshjet Siguruese që do të lidhen me Bankën Kombëtare Tregtare sha për shtesën e kredisë me kufi/ Overdraft në shumën 100,000,000 (njëqind milion ALL).

7. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrator I HEC Lanabregas sha.

Ky vendim hyn në fuqi menjëhere.

AKSIONARI I VETËM I HEC LANABREGAS SH.A
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SHA
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ELTON HAXHIA

Tirane, me 07/11/2022
Nr 573 Prot.

VENDIM I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
I SHOQERISË "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SHA
(Mbi bazën e Nenit 18 të Statutit të shoqërisë UKT SHA)

Sot në Tiranë, më datë 07/11/2022 (dymijë e njëzetë e dy), në selinë e shoqerisë **"UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SHA** me zyra qëndrore të shoqërisë në Shqiperi në adresën "Rruga e Kavajës, Ndërtesa 133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027", Tirane, nje shoqëri e krijuar që vepron si person juridik në bazë të ligjeve shqiptare, e regjistruar në Qëndren Kombëtare të Biznesit në datë 27/09/2017, me Numër Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) L72320033P, e regjistruar në Organet Tatimore Tiranë me NIPT Nr. L72320033P, e cila përfaqesohet nga:

- Z. Elton Fatmir Kacidhja, i datëlindjes 18.12.1981, shtetas Shqiptar, mbajtës i dokumentit të Identifikimit karte identiteti me Nr. SSN.I112180471I, banues në adresën Tiranë, madhor me zotesi te plotë juridike për të veprruar, në cilesinë e Administratorit/ Drejtorit te Pergjithshëm te shoqërisë.

Pas diskutimit mbi cështjet e rendit te ditës:

VENDOSI:

- Shoqëria **"UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SHA** ka prane **Bankës Kombëtare Tregtare (BKT)**, Dega "Rruga Elbasanit", Tiranë nje limit kreditimi me kufi/ overdraft ne shumen **850,000,000(tetëqind e pesëdhjetëmilionë) lekë**, linje e cila eshte rinovuar per perdorim edhe per 12 muaj te tjere ne vazhdim. Nisur nga nevoja e shoqërisë për përdorimin e kësaj Kredie (Me kufi/Overdraft), **Miraton dhe Vendos** të procedohet më tej me:
  - Rritjen e limit te kredisë me kufi/ Overdraftit në shumën 100,000,000 (njëqind milion) ALL, e cila do të përdoret për blerje inventari sipas nevojave të kompanisë/kapital punues, me afat 12(dymbëdhjetë) mujorë. Ne total limiti i kredise me kufi/ Overdraft behet 950,000,000 (nenteqind e pesedhjete milion) ALL.
  - Miratimin për bartësimin në formën e **Pengut të te Ardhurave te Arkëtueshme, të te ardhurave** te shoqerise "UJESJELLES KANALIZIME TIRANE" SHA (UKT) që do te trjedhin nga "Pagimi i Faturave te Ujit per llogari te "UJESJELLES KANALIZIME TIRANE" SHA (UKT)" nëpërmjet **Bankës Kombëtare Tregtare (BKT)**, Dega "Rruga Elbasanit", Tiranë, duke garantuar limitin e ri te kredisë me kufi/ Overdraft ne shumen 950,000,000 (nenteqind e pesedhjete milion) ALL *(perfshire limitin ekzistues dhe shtesen e limit te ri te kredise me kufi/ Overdrafte)* qe do te merret nga ana e shoqerise UJESJELLES KANALIZIME TIRANE SHA dhe te akorduara nga ana e "Bankës Kombëtare Tregtare" sha.

SHOQËRIA "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SHA
DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ELTON KACIDHJA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI AKSIONARE"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L72320033P			
2. Data e Regjistrimit	27/09/2017			
3. Emri i Subjektit	UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	27/09/2017			
6. Kohëzgjatja	Nga: 27/09/2017 Deri:			
7. Zyra qëndrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga e Kavajës, Ndërtesa 133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027			
8. Kapitali	6.792.760.000,000			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	6792760000.0000			
10. Numri i aksioneve:	6.792.760,000			
10.1 Vlera nominale:	1.000,000			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejte vote	pa të drejte vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	1.Objekti i shoqerise brenda territorit te bashkise se krijuar sipas ligjit nr.115/2014, "Per ndarjen administrative-territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise", dhe akteve te ndarjes, eshte: a) Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i			

	konsumatoreve dhe shitja e tij; b)Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me ujë te pijshem si dhe të impianteve te pastrimit te tyre; c)Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve; c)Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura; d)Mirembajtja e sistemeve te ujerave te ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre. 2.Shoqeria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirect me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. 3.Shoqeria ushtron veprimtarine e saj në perputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi. Kryerja e aktiviteteve laboratorike.	
13. Sistemi i administrimit	☒ me një nivel ☐ me dy nivele	
14. Administratori/ët	Elton Kacidhja	
14.1 Afati i emërimit	Nga: 16/10/2020	Deri: 16/10/2023
15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka).		
16. Anëtarët e Këshillit të Administrimit *(plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)*	Alban Dokushi	
16.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
16.2 Afati i emërimit	Nga: 16/10/2020	Deri: 16/10/2023
17. Anëtar i Pavarur	Po	
17.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Jo	
17.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
18. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
19. Anëtarët e Këshillit të Administrimit *(plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)*	Taulant Tusha	
19.1 Kryetar/anëtar	Kryetar	
19.2 Afati i emërimit	Nga: 16/10/2020	Deri: 16/10/2023
20. Anëtar i Pavarur	Po	
20.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Jo	
20.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
21. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		

22. Anëtarët e Këshillit të Administrimit *(plotësohet nëse është Sh.a me një nivel)*	Elton Kacidhja	
22.1 Kryetar/anëtar	Anetar	
22.2 Afati i emërimit	Nga: 16/10/2020	Deri: 16/10/2023
23. Anëtar i Pavarur	Po	
23.1 Përfaqësues i Punëmarrësve	Jo	
23.2 Kushtet e pjesëmarrjes		
24. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore.		
25. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar	Sokol Toska	
25.1 Afati i emërimit	Nga: 27/09/2017	Deri:
26. Eksperti/ët Kontabël i Autorizuar	MAZARS	
26.1 Afati i emërimit	Nga: 27/09/2017	Deri:
27. Aksionarët	Bashkia Tirane	
27.1 Numri i Aksioneve	Me te drejte vote: 6792760.0000 Pa te drejte vote:	
27.2 Përqindja e pjesëmarrjes	100,000	
28. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Tirane TIRANE Rruga Arkitekt Sinani, Pasuria Nr.6/213, Nd+1-1, Pike e Kujdesit ndaj Klientit. Tirane Tirane TIRANE Tirane, Rruga "Sami Frashëri". Pallati nr.22, Pikë e Kujdesit ndaj Klientit. Tirane Tirane TIRANE Rruga 3 Deshmoret, Pallati Dilo Kons, Dyqani Nr.2, Arka Yzberisht. Tirane Tirane TIRANE Njesia Administrative nr.5, Rruga "Skënder Luarasi", Pallati "Aurora", Godina 2/2, njesia nr.8, Pike e Kujdesit ndaj Klientit. Tirane Tirane TIRANE Rruga Ali Demi, Pallati Gener 2, Dyqani Nr.1, Arka Ali Demi Nr.1 Tirane Tirane TIRANE Rruga Muhamet Gjollesha, Arka Njesia Nr.4/1 Tirane Tirane TIRANE Rruga e Barrikadave, Nr.63, Arka Rr Barrikadave Nr.2. Tirane Tirane TIRANE Rruga Muhamet Gjollesha, Arka Njesia Nr.4 Tirane Kashar YZBERISH Tiranë, Rruga "3 Dëshmorët", Pallati nr. 114, Nr. 2, Yzberish, Njesia Administrative	

	Kashar, Pike e Kujdesit ndaj Klientit Tirane Tirane TIRANE Rruga Petro Nini Luarasi, Pallati 10/1, Arka Njesia Nr.2 Tirane Tirane TIRANE Rruga Muhamet Deliu, Arka Qesarak. Tirane Tirane TIRANE Rruga "Dritan Hoxha", Pallatet Hawai, perballe shkollës "Ahmet Gashi" , Pike e Kujdesit ndaj Klientit. Tirane Tirane TIRANE Rruga Preng Bib Doda, Blloku Vasil Shanto, Arka Njesia Nr.3 Tirane Tirane TIRANE Rruga Pjeter Budi, pallati 14/1, shkalla 7, dyqani nr.1, perballe Kopshtit nr.41 Tirane Tirane TIRANE Rruga e Kavajes, pallati "Delijorgji" Tirane Tirane TIRANE Rrethrrotullimi Sauk, Arka Sauk. Tirane Tirane TIRANE Rruga Qemal Butka, pallati 5 katesh, njesia/dyqani nr.3, Njesia Administrative nr.5, Pike e Kujdesit ndaj Klientit Tirane Tirane TIRANE Rruga Ali Demi, Pallati Gener 2, Dyqani Nr.1, Arka Ali Demi Nr.2. Tirane Tirane TIRANE Rruga Aleksander Moisiu, Pallati nr.40, kati 1, Zyrë e Kujdesit ndaj Klientit Tirane Tirane TIRANE Rruga Bardhyl, pallati 9, shkalla1, apartamenti 2, Arka Njesia nr.1, Arka Njesia Nr.1/2 Tirane Tirane TIRANE Rruga Vasil Tromara, Pallati Bino & Hoxha shpk, Dyaqani D-6, Pike e Kujdesit ndaj Klientit. Tirane Tirane TIRANE Rruga Petro Nini Luarasi, Pallati 10/1, Arka Njesia Nr.2/1 Tirane Tirane TIRANE Rruga Mine Peza, Pallati 2, Dyqani Nr.10, Arka Mine Peza Nr.1 Tirane Tirane TIRANE Rruga "Don Bosko", nr.28, kati 1, Pike e Kujdesit ndaj Klientit. Tirane Tirane TIRANE Porta ish Kombinati Tekstil, Arka Njesia Nr.5 Tirane Tirane TIRANE Rruga Mine Peza, Pallati 2, Dyqani Nr.10, Arka Mine Peza Nr.2 Tirane Tirane TIRANE Rruga e Kastrioteve, Kthesa e Kamzes, Pallati Euro 3 D, Zona Kadastrale 2679, Pike e Kujdesit ndaj Klientit.
29. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	E-Mail: info@ukt.al Telefon: 08004488
30. Statusi:	Aktiv

Datë: 16/11/2022

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2022/11/16 12:16:52 +01:00
L72320033P20221116121642992006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)